

VENDIM
Nr. 1154, datë 24.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 811, DATË 26.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR NDËRTIMIN E LANDFILLIT, INCENERATORIT DHE REHABILITIMIN E VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE’, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 811, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe “vresht”, me vlerë të përgjithshme 325 770 560 (treqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë.”;

b) pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Vlera shtesë prej 40 774 720 (dyzet milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.”;

c) pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”;

ç) tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 811, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 811, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, ‘Për
 shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private,
 që preken nga realizimi i projektit: ‘Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe
 rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë dhe prodhimin e energjisë
 elektrike’, Tiranë”**

Nr.	Nr. sipas shkresës së hipotekës	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Shënime
1		Bashkëpronarët XHEPA etj.	Vresht	3321	301/17	3600	3600	448	1612800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
2	13	Zenepe Hoxha	Vresht	3321	185/2	5200	5200	448	2329600.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
3	25	Jakup Lamuç	Arë	3321	295/4	1000	100	448	44800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
4	19	Kasem Lamuç	Arë	3321	298/22	500	100	448	44800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
SIP. TOTALE							9000		4032000.00	

Lista e pasurive pa informacion

1	1	Pa informacion	Arë	3321	172	98560	77820	448	34863360.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
2	49 dhe 50	Pa informacion	Arë	3321	331/4	805	805	448	360640.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
3	50 dhe 49	Pa informacion	Arë	3321	331/5	1125	1125	448	504000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
4		Pa informacion	Arë	3321	317/1	615	615	448	275520.00	Në sistemin e ZRPP-së.
5		Pa informacion	Arë	3321	332/19	1650	1650	448	739200.00	Në sistemin e ZRPP-së.
Vlera e pasurive pa informacion									36742720.00	

VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT TË PASURIVE ME EMRA PRONARËSH DHE E PASURIVE PA INFORMACION									40774720.00	
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--------------------	--

Vlerësimi i pasurive të llojit “tokë arë” dhe “vresht”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.